



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 3580 Prot.

Fier më 21.03.2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. 28, datë 21/03/2025

“Për shpërndarjen e 3 banesave sociale me qira, të cilat rezultojnë të lira nga menaxhimi i banesave sociale me qira pranë bllokut të Banesave Sociale Lagjja “16 Prilli” Fier, për 3 familje të pastreha”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____/____/2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga Komisioni i Strehimit, mbi shpërndarjen e 3 (tre) banesave sociale me qira që rezultojnë të lira bazuar në informacionin zyrtar të Zyrës së Administrimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira, Bashkia Fier me shkresën nr 1862, datë 11.02.2025 “Informacion mbi tre apartamentet bosh në banesat sociale me qira”, të Zyrës së Administrimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me qira” për familje të pastreha që do të përfitojnë këto banesa.

Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës të familjeve të pastreha që kanë aplikuar në sistemin on-line të banesave sociale me qira në portalin e -albania, si dhe dokumentacionit të depozituar prej këtyre familjeve në Zyrën e Shërbimit me Një Ndalesë, Bashkia Fier në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKB nr. 128, datë 31.10.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit ” Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes për vitin 2025”, si dhe nenit 54 gërma “k” të Ligjit Nr.139 /2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar,

Propozon:

1. Shpërndarjen e 3 banesave sociale me qira, të cilat rezultojnë të lira nga menaxhimi i banesave sociale me qira pranë bllokut të Banesave Sociale Lagjja “16 Prilli” Fier, për 3 familjet e pastreha” si më poshtë :
 - **Ndoreja Adil Shotë** në apartamentin më strukturë “Garsonierë” Godina G3, Ap.9, kati 3 banim, shkalla 1;
 - **Stiven Aleks Liko** në apartamentin më strukturë “Garsonierë” Godina G3, Ap.12, kati 4 banim, shkalla 1;
 - **Irisa Ferdinand Ramushaj** , në apartamentin me strukturë 1+1, Godina G4+5, Ap.17, Kati 3 banim, shkalla 2;

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Administrimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira, Bashkia Fier dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Fier.

Komisioni i Strehimit

Pranvera Çina

Merita Bitri

Melsi Bogdani

Themion Mile

Endri Jaupaj

Kreshnik Dapri

Rrapi Gjika

Elvi Daka

Denisa Azizaj

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË ME AUTORIZIM

Sekretari i Përgjithshëm

Martin Dodi

